

Shpallja publike për shprehje interesi

Laboratori për Aktivitete të Biznesit (LAB) - ka kënaqësinë të shpall ftesën publike nën skemën e projektit "Laboratori për Aktivitete të Biznesit", për themelimin e aktiviteteve të reja ekonomike dhe përmirësimin e njohurive dhe aftësive biznese për zhvillimin rural të sektorit agro-pybor në Komunën e Hanit të Elezit.

Kjo përkrahje alternative e Sharrcem - Titan Group përmes LAB -it, është kontribut i drejtëpërdrejt për gjithë banorët të interesuar të Komunës së Hanit të Elezit që duke krijuar mundësi për të rritur nivelin e shfrytëzimit të potencialeve në sektorin agro pyjore të krijohen mundësi për vende të reja të punës përmes vtëpunësimit dhe të hyra shtesë për neveojat e familjes dhe për zgjerimin e bizneseve të tyre fillestare.

Ne ju inkurajojmë që të ndani këtë informatë më të gjithë ata që mund të jenë të interesuar për këtë mundësi.

Sektorët aktiv të cilët do të përkrahen për zgjerim:

1. Serra

Objektivi: Zgjerimi i sipërfaqeve ekzistuese për kultivim të perimeve në serra.

Titulli: Furnizim me serra, farëra, fidanë dhe inpute tjera përcjellëse, dy serra të tipit "Bllok" me sipërfaqe 500 m² për kultivimin intensiv të perimeve.

2. Mjedër

Objektivi: Zgjerimi i sipërfaqeve ekzistuese për prodhimin e frutave të imta - mjedër.

Titulli: Furnizim me fidanë të mjedrës si dhe inputet tjera përcjellëse, deri në tri sipërfaqe nga 0,2 ha.

3. Luleshtrydhe

Objektivi : Zgjerimi i sipërfaqeve ekzistuese për prodhim të frutave të imta - luleshtrydhe.

Titulli: Furnizim me fidanë të luleshtrydhes si dhe inputet tjera përcjellëse, deri në tri sipërfaqe nga 0,2 ha.

4. Bletë

Objektivi : Zgjerim i investimeve për shtim të fondit të kolonive të bletëve dhe prodhim të mjaltit.

Titulli: Furnizim me koloni të bletëve dhe inputeve tjera përcjellëse, deri në pesë fermerë me nga dhjetë koloni të bletëve.

Sektorët e ri që do të përkrahen:

5. Blegtori

Objektivi : Investime në ngritjen e fondit të lopëve qumështore për prodhim të qumështit.

Titulli: Furnizim me 10 lopë qumështore, pajisje dhe inpute tjera përcjellëse, një fermer.

6. Vreshtari

Objektivi : Investime testuese në ngritjen e vreshtave me varietete të rrushit të tryezës.

Titulli: Furnizim me fidanë dhe inpute tjera përcjellëse, deri në dy sipërfaqe me nga 0,2 ha.

Mbështetja do të menaxhohet nga LAB në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (BPZHR) dhe Kryetarët e Këshillave Lokal të Hanit të Elezit.

Aplikacionet duhet të dorëzohen më së largu deri më datë **15 Korrik 2015**, në orën 16:00.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në zyrat e LAB në adresën:

Adem Jashari p.n 71500 Hani i Elezit

Për çdo informatë në lidhje me shpalljen publike dhe zbatimin e tij mund të merren në zyrat e LAB-it.

Kopjet e udhëzuesit për plotësimin e aplikacionit dhe formularin mund të merrni direkt në zyrën LAB-it

Aplikantët duhet të mbajnë nga një kopje të aplikacionit të dorëzuar dhe kopjet e dokumenteve të bashkangjitura.

Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen në afatin e dhënë dhe sipas rregullave dhe kushteve të vendosura nga LAB.